



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 18 prill 2018
Nr. ref.: RK 1216/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI134/17

Parashtrues

Qazim Dajakaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 145/2017,
të 18 tetorit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Qazim Dajakaj nga fshati Rakinicë, komuna e Skenderajt (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 145/2017, të 18 tetorit 2017 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) lidhur me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës (PAKR. nr. 289/2016), të 11 janarit 2017 (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë (PKR. nr. 540/2011), të 12 shkurtit 2016 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon që i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 nëntor 2017, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të dorëzuar në postë, më 8 nëntor 2017.
6. Më 16 nëntor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
7. Më 22 nëntor 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që të dorëzojë në Gjykatë, formularin e kërkesës si dhe kopjet e vendimeve të kontestuara. Në të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 1 dhjetor 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara nga Gjykata.
9. Më 21 shkurt 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Në janar të vitit 2011, parashtuesi i kërkesës i kishte huazuar personit B. O. një shumë prej 10.000 euro.
11. Më 14 janar 2011, parashtruesi i kërkesës dhe B. O. kishin lidhur kontratë që parashihte se nëse B. O. nuk arrinte të kthente borxhin e cekur më lart, ngastra kadastrale UL-7070S079-00390 ZK Cermjan, komuna e Gjakovës, në sipërfaqe prej 50 ari (në tekstin e mëtejme: ngastra kontestuese) do të kalonte në emër të parashtruesit.
12. Më 20 shtator 2011, Prokuroria Publike Komunale në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Komunale), me Aktakuzën PP. nr. 535/2011 kishte akuzuar parashtruesin nën dyshimin e bazuar se në bashkëpunim me personin M. T. kishte kryer veprën penale nga neni 270 [Kontraktimi i Përfitimit joproporcional] lidhur me nenin 23 [Bashkëkryerja] të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK), si rezultat i nënshkrimit të kontratës së cekur më lart.
13. Më 12 shkurt 2016, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit PKR. nr. 540/2011 shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale kontraktim i përfitimit joproporcional në bashkëpunim me personin M. T. dhe e dënoi me dënim me burg prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se parashtruesi i kërkesës nuk do të kryej ndonjë vepër penale në afat prej 3 (tri) vjetësh.
14. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore PKR. nr. 540/2011, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal.
15. Ankesë parashtroi edhe Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Prokurori i Prokurorisë Themelore), për shkak të vendimit mbi sanksionin penal.
16. Më 11 janar 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 289/2016, refuzoi ankesat e Prokurorit të Prokurorisë Themelore dhe të parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore (PKR. nr. 540/2011). Në lidhje me parashtruesin e kërkesës, Gjykata e Apelit, ndër të tjera, arsyetoi se parashtruesi i kërkesës kishte nënshkruar kontratë për huadhënie me personin B. O. dhe duke përdorur vështirësinë financiare të tij, kontrakttoi haptazi përfitim joproporcional, pasi vlera reale e parcelës së kontestuar, sipas dëshmitarëve, ishte shumë më e lartë se shuma e kontraktuar prej 10.000 euro.
17. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (PKR. nr. 540/2011) dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (PAKR. nr. 289/2016), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, duke pretenduar se nga data kur parashtruesi pretendohet që e ka kryer veprën penale deri te pranimi i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit kanë

kaluar më tepër se 6 (gjashtë) vjet dhe si pasojë, vepra penale është parashkruar.

18. Më 18 tetor 2017, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit Pml. nr. 145/2017, refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (PKR. nr. 540/2011) dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (PAKR. nr. 289/2016) duke arsyetuar, ndër të tjera, se vepra penale është kryer më 14 janar 2011, ndërsa Gjykata e Apelit ka nxjerrë Aktgjykimin e saj më 11 janar 2017, që do të thotë se nga data e kryerjes së veprës penale e deri me datën e marrjes së aktgjykimit dënues, kanë kaluar më pak se 6 (gjashtë) vjet dhe se vepra penale nuk është parashkruar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të drejtave të tij të garantuara me nenet 24 [Barazi para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës.
20. Parashtruesi i kërkesës thekson se, Gjykata e Apelit ka pasur obligim që të më lirojë nga akuza pasi *“nga data 14 janar 2011, kur pretendohet se është kryer vepra penale, deri me datën 8 maj 2017 kur e kam pranuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit kanë kaluar 6 vjet”* dhe si pasojë, është arritur afati i parashkrimit. Parashtruesi po ashtu pretendon se, *“data e dorëzimit [të Aktgjykimit, 8 maj 2017] është relevante [për të vlerësuar parashkrimin]”,* pasi *“data 11 janar 2017, [kur është nxjerrë Aktgjykimi], është e manipuluar sepse nuk ka mundësi që lënda të vonohet nga seanca deri te dorëzimi, prej datës 11 janar deri me datën 8 maj.”*
21. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se është diskriminuar nga gjykatat e rregullta për faktin që është nga Drenica, duke shtuar se *“jam dënuar pa faj”* edhe pse *“unë kam lidhur kontratë ligjore dhe se vlerësimi se çmimi i kontraktuar është joproporcional me vlerën nuk është i sakt pasi në fshat çmimi i tokës është 100-deri 200 euro dhe jo 2000 euro për ari”* ashtu si është konstatuar nga gjykatat.
22. Parashtruesi në fund kërkon nga Gjykata, që të deklarojë kërkesën të pranueshme, të konstatojë shkelje të së drejtës për barazi para ligjit, si dhe të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe të deklarojë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe rastin e tij ta kthej në rivendosje.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili parasheh që:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

25. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]”

26. Lidhur me si më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesi ka parashtruar kërkesën si palë e autorizuar, kërkesën e ka parashtruar brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj.

27. Megjithatë, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

28. Përveç kësaj, Gjykata rikujton rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

29. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit kanë të bëjnë me mënyrën se si gjykatat e rregullta kanë aplikuar KPK-në dhe KPPK-në, dhe mund të përmbliken si në vijim:

(i) vepra penale për të cilën është akuzuar është parashkruar dhe se data e nxjerrjes së aktgjykimit nuk është relevante, dhe

(ii) vendimi që shpall fajtor parashtruesin nuk është i bazuar pasi kontrata e lidhur mes tij dhe B. O. është e ligjshme, sepse çmimi i kontraktuar është proporcional me vlerën e parcelës së kontestuar.

30. Lidhur me pretendimin e parë, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme në përgjigje ndaj pretendimit të parashtruesit ku, ndër të tjera,

thuhet: “vepra penale është kryer me datë 14.01.2011, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës, ka marrë aktgjykimin [...] me datë 11.01.2017, që do të thotë se nga data e kryerjes se veprës penale e deri me datën e marrjes së aktgjykimit dënues kanë kaluar 5 (pesë) vite e 11 muaj e 27 ditë, pra nuk është shkaktuar parashkrimi absolut i ndjekjes penale.”

31. Sa i përket pretendimit të dytë të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit kishte arsyetuar vendimin e saj në lidhje me pretendimin se parashtruesi nuk kishte lidhur kontratë të paligjshme pasi vlera reale për ngastrën e kontestuar ishte 200 euro për ari, duke arsyetuar se parashtruesi i kërkesës dhe personi M. T. “duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të B. O. kontraktajnë haptazi përfitim joproporcional lidhur me huan e dhënë, duke lidhur kontratë të shitblerjes të [ngastrën kontestuese] vlera e së cilës është joproporcionale me huan e dhënë [pasi] bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve vlera reale e një ari të asaj toke është mbi 2000€.”
32. Prandaj, Gjykata vëren se pas ankesës së parashtruesit të kërkesës dhe kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, kanë hedhur poshtë pretendimet e tij për shkelje të KPK-së dhe KPPK-së duke mbështetur plotësisht Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, respektivisht të Gjykatës së Apelit. Të dy instancat i janë përgjigjur pretendimeve për shkelje të KPK-së dhe KPPK-së, të ngritura nga parashtruesi i kërkesës.
33. Gjykata rikujton se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të vendosur nëse një parashtrues ka qenë fajtor për kryerjen e veprës penale apo jo. Ajo nuk ka as juridiksion për të vlerësuar nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë apo për të vlerësuar nëse gjyqtarët e gjykatave të rregullta kanë pasur dëshmi të mjaftueshme për të përcaktuar fajësinë e një parashtruesi të kërkesës. (Shih rastin KI68/17, parashtrues: *Fadil Rashiti*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 qershorit 2017, para 50).
34. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme apo ndonjë gjykatë tjetër e instancës më të ulët, përveç; nëse dhe për aq sa ajo mund të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Gjykata rithekson më tej se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih *mutatis mutandis*, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës* nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
35. Fakti i thjeshtë që parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit të tij nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentuar për shkelje të të drejtave të tij të mbrojtura me Kushtetutë. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në gjykatat e rregullta në përgjithësi janë mbajtur në mënyrë të tillë, sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih rastin *Edwards kundër*

Mbretërisë së Bashkuar, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

36. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se arsyetimi në gjykatat e rregullta, duke iu referuar pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të ligjit penal dhe të procedurës penale, është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
37. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur pretendimin e tij për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.
38. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata, që të konstatojë se gjykatat e rregullta i kishin shkelur të drejtën e tij për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës.
39. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që trajtimi është diskriminues nëse një individ trajtohet ndryshe nga të tjerët në pozita ose situata të ngjashme dhe nëse ky ndryshim në trajtim nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Gjykata përsërit se trajtimi i ndryshëm duhet të ndjekë një qëllim legjitim për të qenë i justifikuar dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet. Shih rastin e GJEDNJ-së, *Marckx kundër Belgjikës*, Kërkesa nr. 6833/74, Aktgjykimi i 13 qershorit 1979, paragrafi 33.
40. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi prima facie dhe as nuk e ka mbështetur pretendimin që tregon se ai ishte i diskriminuar në procedurat në gjykatat e rregullta.
41. Prandaj, si përfundim, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë shkeljen e pretenduar të të drejtave kushtetuese për barazi para ligjit dhe gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në të cilat ai thirret dhe se ai nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.
42. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, më 21 shkurt 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi